

**STATUT**  
**I SHOQERISE "3E-K CONSULTING" sh.p.k.**

**DISPOZITA TE PERGJITHESHME**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "**3E-K CONSULTING**" sh.p.k., eshte themeluar sipas akt themelimit dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruar nga ortaket e saj bazuar ne "**Ligjin**" Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "**Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare**";

**KREU I**

**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**NENI 1**

**DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT**

Sot, më 17/05/2021 ne, themeluesit, kemi krijuar një **shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**

Shoqeria do te emerohet "**3E-K CONSULTING**" sh.p.k.



Themeluesit e shoqërisë janë:

1.- **Znj. Rozalina Sula**, shtetase shqiptare, lindur ne Kukes, me date 07.10.1997 mbajtese e kartes se identitetit me nr. 033015493 dhe nr. Personal J76007042P, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 25%.

2.- **Z. Enea Kaçi**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me date 08.07.1991 mbajtes i kartes se identitetit me nr. 035430494 dhe nr. Personal J10708091E madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 25%.

3.- **Znj. Aida Çollari** , shtetase shqiptare, lindur ne Pogradec, me date 20.01.1991 mbajtese e pashaportes me nr. BI7940773 dhe nr. Personal J15122063P, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 25%.

4.- **Z. Elvis Uku**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane , me date 17.05.1982 mbajtes pashaportes me nr. BG6385519 dhe nr. Personal I20517056J , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 25%.






## NENI 2

### OBJEKTI I SHOQERISE

Projektim, mbikqyrje dhe kolaudim ne fushen e ndertimeve dhe vleresim te pasurive te paluajtshme. Veprimtari ekspertize lidhur me ndikimin në mjedis dhe auditim mjedisor. Studim dhe pergatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te cdo lloj. Hartimi i akteve te ekspertizes per zjarret e rena. Sherbime te planifikimt urban. Ne fushen e projektimit dhe te ndertimit: kat. 1/ eplanvendosje e objekteve te vecanta, kat. 2/a, projektme dhe ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Deri ne dy kate dhe kompletimin me instalimet e nevojshme per to, b- projektme dhe ndertime civile industriale, turistike, bujqesore etj. Dhe kompletimin e instalimeve te nevojshme per to; d- Projektim peizazhi (sistemime, lulishte, vepra arti, dekori etj.) e- projektim interieri, mobile, pajisjes, dizajn industrial. Ne fushen e ndertimit per zbatim: punime dheu, sistemime, tarracime, prodhim elementesh te parafabrikuara betoni e betonarmeje dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, punime elektrike, linja TL, TU, impiante elektrike, telefoni, citofoni, dhe mirembajtja e tyre, ndertim rruge, kat. V, VI ndertime rruge kat. III, II, I, ndertim fusha aviacioni, veshje asfaltobeton te rrugeve (ndertim mbishtrese) si dhe sistemim e asfaltim sheshe, ndertim vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndertime ujesjellesa dhe kanalizime, sillosa, kulla, kulla uji. Pre betonarmeje dhe metalike, punime karpentjerie metalike, shpime pusesh gjeologjike inxhinjerie dhe hidrogjeologjike, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, nivelime topografike, punime topogjeodezike, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash. Nivelime topografike, punime topogjeodezike, punime siperfaqe te gjelberia parqe, lulishte, instalimi i impianteve ngritese dhe transportuese (ashensore etj.) instalimi i impianteve te ngrohjes dhe ftohjes, instalimi i impianteve higjenike, instalimi i impianteve nenpresion, restaurimi i ndertesave monument kulture, punime restaurimi i ndertesave monument kulture, punime restaurimi ne vepra arkeologjike, ndertime gazsjellese, naftesjellese, ndertime diga, galeri, tunele, punime mbrojtje te sistemimit hidraulik 9imentime, kanale dhe impiante vaditje, punime karpentiere druri dhe metal, instalimet dhe impianteve nenpresion, instalimet per nenstacionet, kabinat e transformatoreve. Prodhim, import —export beton, beton armeje dhe





cdo nenproduktit te tij, interte etj. Organizimi i transportit te udhetareve dhe te mallrave me mjete te komunikacionit ajror, tokesor dhe detar, celja e zyrave te agjencive turistike dhe te shitjes se biletave per udhetime brenda dhe jashte vendit me te gjitha llojet e mjeteve, organizimin e sherbimeve, ndihme juridike, kurse profesionale per gjuhe te huaja, kompjuter dhe sekretari, shitje kancelari. Ne fushen e tregtise import — eksporti, me shumice dhe pakice, te mallrave industriale, ushqimore, bujqesor dhe blegtorale, veshmbathje, konfeksione, prodhime e tregtim te materialeve te ndertimit, inerte, rere, zhavorr, automjeteve, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobileve, artikujve kozmetike, lendeve te perpunuara dhe te paperpunuara , e bimeve medicinave, te lendeve drusore, plastike, duraluminit, tregtim me pakice te karburanteve dhe vajrave lubrifikante. Ne fusha te tjera: hapjen e bar bufeve, restoranteve, pikave te servilit, parkim automjetesh, lavazhit, hoteleve, fshatrave turistik, moteleve si dhe agjencive per shitblerje, dhenie me qira te pasurive te mndshme dhe te patundshem, agjencive per shitblerje, agjenci komisioneve, agjenci transporti, transport te udhetareve dhe te mallrave si brenda vendit ashtu dhe jashte tij. Vleresim i ndikimit ne mjedis dhe auditim mjedisor, grumbullim, transportim, ruajtje, magazinim, transferim te mbetjeve jo te rezikshme urbane, ujrave te zeza, llumrave, mbetjet nga prishjet dhe ndertimet.

### **NENI 3**

#### **ADRESA E SHOQERISE**

Shoqeria do te kete Seline e saj ne adresen: Tirane, Tirane, TIRANE ne rrugen “George W. Bush” Nr. 10 Tirane


Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, konform me ligjin shqiptar ose te huaj.

### **NENI 4**

#### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe te pakufizuar, periudhe e cila mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Ortakeve.

## **KREU II**





## KAPITALI

### **NENI 5**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (njqind mije) Lekë dhe i ndare ne 4 (kater) kuota, sipas pjesëmarrjes se themeluesve në kapitalin e shoqërisë në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Znj. Rozalina Sula**, shtetase shqiptare, lindur ne Kukes, me date 07.10.1997 mbajtese e kartes se identitetit me nr. 033015493 dhe nr. Personal J76007042P, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 25%.

2. Ortaku themelues **Z. Enea Kaçi**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me date 08.07.1991 mbajtes i kartes se identitetit me nr. 035430494 dhe nr. Personal J10708091E madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 25%.

3. Ortaku themelues **Znj. Aida Çollari**, shtetase shqiptare, lindur ne Pogradec, me date 20.01.1991 mbajtese e pashaportes me nr. BI7940773 dhe nr. Personal J15122063P, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 25%.

4. Ortaku themelues **Z. Elvis Uku**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me date 17.05.1982 mbajtes pashaportes me nr. BG6385519 dhe nr. Personal I20517056J, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 25%.


### **NENI 6**

#### **ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Mbledhja e asamblese se ortakeve eshte organi vendimmarres per rritjen dhe zvogelimin e kapitalit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë, por vete ortaku pranon rivlersimin e pjeses se tij takuese ne shoqeri ne porporcion me rritjen e kapitalit .





Zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## **NENI 7 TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRESE, DREJTUESE DHE STRUKTURE TË SHOQERISE**


## **NENI 8 ORGANET VENDIM-MARRESE DHE DREJTUESE TË SHOQERISE**

Shoqëria është e organizuar në organet e mëposhtme:

- 1- Asambleja e Ortakeve Te Shoqërisë
- 2- Administratori

**Asambleja e Ortakeve** është organi me i lartë vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme në përputhje me nenin 10 dhe 11 të statutit:






- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë dhe shperndarja e fitimit/humbjes vjetore;
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- m) njeherazi mund te vendoset mbi lejimin ose marrjen pjese (hyrjen) ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, nga një person i tretë me autorizimin perkates.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **NENI 9**

### **MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**





Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 5 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **NENI 10 KUORUMI**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51% për qind të kuotave.


Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se tre te katertat ose 75% te numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **NENI 11 MARRJA E VENDIMEVE**

Asambleja e përgjithshme vendos me 75% ose me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës ceshtjet e meposhteme:

1. për ndryshimin e statutit
2. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar
3. shpërndarjen e fitimeve
4. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.





Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, sipas nenit 10 pika 1, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.


## **NENI 12 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

## **NENI 13 ADMINISTRIMI**

1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë





ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë për një afat 5 vjeçar nga data e regjistrimit të kësaj shoqërie pranë QKB-se.

- **Z.Enea Guma** shtetas shqiptar, lindur në Fier me datë 25.05.1990 mbajtes i kartës së identitetit me nr. 037015462 dhe nr. Personal J00525104D madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, i cili në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretet në gjithë veprimtarinë e shoqërisë.

#### **NENI 14**

#### **KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

Administratori është organi drejtuesi i shoqërisë i cili ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblëja e përgjithshme, të kryejë të gjitha veprimet bankare me çdo bankë të nivelit të dytë, pa asnjë kufizim ;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare, të nënshkruajë kontrata ,noteriale ose jo, apo çdo lloj akti tjetër të domosdoshëm që lidhet me aktivitetin e shoqërisë pa kufizim;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; 5
- d) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblësë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;



g) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **NENI 15 PËRGJEGJESITË E ADMINISTRATORIT**


Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare"

1.) administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;





b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar të dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, kryen veprime e meposhteme:

a) u kthen ortakeve kontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;

c) u shperndan aktivet e shoqerise;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur në bazë të gjendjes financiare duhet të parashikohet që shoqëria nuk kishte aftësi pagueuese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi;

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit



Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **KREU IV**

#### **VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

##### **NENI 16 VITI FINANCIAR**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **NENI 17 EKSPERTET**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per atë per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.



#### **KREU V**

#### **PRISHJA -RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

##### **NENI 18 PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;





b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## **NENI 19 RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

## **NENI 20 BAZA LIGJORE**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 21 MOSMARRËVESHJET**



Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

#### ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

**Znj.Rozalina SULA**

Rozalina Sula 

**Z.Enea KAÇI**

Enea Kaçi 

**Znj. Aida ÇOLLARI**

Aida Çollari 

**Z. Elvis UKU**

Elvis Uku 